REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 820/20
Datë/Datum. 19.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NP"TERMOKOS"Sh.a**

Për Aktivitetin me numër të Prokurimit: **TER-020-030-2.2.1**

Titulli: **MBIKQYRJA E OBJEKTIT TE RI ADMINISTRATIV DHE OBJEKTEVE PERCJELLESE TE NP"TERMOKOS"SH.A**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.N.SH "VIZION PROJECT"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

KODRA E DIELLIT BLL.IV, HY.IV, NR.20
(Adresa)

PRISHTINË — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 261 361 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

SHKELQIM OSMANI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@vizionproject.com
(Adresa elektronike)

19.10.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

N.N.SH. Vizion Project PRISHTINE REPUBLIKA E KOSOVËS

_____
(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim për Kontratë: 31.08.2020 *Afati për dorzimin e ofertave: 11.09.2020 ora 13:00* *Njoftim mbi Vendimin e AK: 30.09.2020* *Kërkesa për rishqyrtim dt. 05.10.2020* *Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt: 09.10.2020*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së

Sipas Vendimit për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim si të pa bazuar të datës 09.10.2020 arsyet e janë:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave të LPP-së dhe kriterit për dhënie të kontratës qe ka qene çmimi më i ulët. Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, Neni 59 Ekzaminimi , Vlerësimi dhe Krahasimi i Tëndereve, Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.
Pretendimi 1 përvoja e stafit mendojme qe është në rregull me O.E të rekomanduar për kontratë.

Kundërshtimi: Ky konstatim është shumë jo-profesional dhe në kundërshtim me çdo dispozite të legjislacionit parësor dhe dytësor për prokurim publik. AK ka shkelur pikërisht nenet 7, 59, 60, 65 dhe 69 të LPP-së dhe RRUOPP dhe poashtu AK nuk ka dhënë përgjigjie konkrete lidhur me pretendimet tona se O.E i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret bazë të dhëna në DT pasi qe ky O.E nuk plotëson **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional.**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1: Qëllimi i LPP-së

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik Neni 41.3

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas pranimit të **Njoftim mbi Vendimin e AK** me datë 30.09.2020 ne si OE pjesmarrës ne këtë aktivitet prokurimi me datë 01.10.2020 kemi bërë **KERKESË PËR QASJE NE DOKUMENTE PUBLIKE** siç e parasheh Ligji Nr. 03/L-215 - për Qasje në Dokumente Publike (nenin 4, pika 2 të ligjit, që thotë: Dokumentet janë të hapura për publikun në bazë të kërkesës së drejtpërdrejt, në bazë të kërkesës së bërë me shkrim ose në formë elektronike), dhe në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Dhe me datë 02.10.2020 kemi pasur qasje në dokumentet e kerkuara sipas Kërkesës tonë dhe pas shikimit te dokumentacionit ne kemi vërejtur dhe kemi dëshmi bindëse se Operatori Ekonomik N.P.T.ARHING (Jeton Canhasi B.I.) është ofertues i pa përgjegjshëm.

Me datë 05.10.2020 kemi bërë **Kërkesë për Rishqyrtim** ku kemi dhënë argumentet dhe deshmitë se O.E i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat ashtu siç është kerkuar në DT.

Me datë 09.10.2020 kemi marrë përgjigje lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim ku AK NP"TERMOKOS"Sh.a ka refuzar Kërkesën tonë për Rishqyrtim si të pa bazuar me preteksitn se AK ka vepruar konform dispozitave të LPP-së.

AK ka përmendur Nenet e Ligjit të Prokurimit Publik ku thuhet se ka vepruar sipas tyre mirëpo pikërisht janë po këto Nene të LPP-së të cilat nuk janë respektuar gjatë fazës së vlerësimit.

Poashtu AK ne asnje rast nuk ka kthyer përgjigjie lidhur me pretendimet tona se O.E i shpallur fitues është i pa përgjegjëshem pasi qe nuk ka plotësuar kriteret bazë të dhëna në DT tek pika **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional.**

Në vijim po ju prezantojm faktet dhe argumentet tona

1. Dëshmia e mospërmbushjes së kërkesave të Dosjes së tenderit nga ana e Operatorit Ekonomik fitues N.P.T.ARHING (Jeton Canhasi B.I.) ka të bëjë me mospërmbushjen e **Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional** ku ne DT kërkohen mës tjerash që si pjesë e stafit të plotësohen edhe këto kërkesa:

2 Arkitektë, 2 inxhinierë të ndërtimtarisë, 2 inxhinierë të elektroteknikës, 2 inxhinierë të makinerisë, 2 inxhinierë të ujësjellësit dhe kanalizimit, 1 inxhinier i gjeodezisë (për të gjithë këta inxhinierë në DT kërkohet që të përmbushin kërkesat në vazhdim: TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES 10 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA);

Po ashtu në DT kërkohen që si pjesë e stafit të jenë edhe:

1 inxhinier i energjisë së efiçencës, 1 ekspert i licencuar dhe me certifikatë për mbrojtje kundër zjarrit, 1 ekspert i licencuar dhe me certifikatë për ndikimin në mjedis (për të gjithë këta inxhinierë në DT kërkohet që të përmbushin kërkesat në vazhdim: TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES 5 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA); si dhe është kërkuar edhe: 1 ekspert i sigurisë dhe kualitetit në punë (ku për këtë ekepert kërkohet: TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PËRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA)

Operatorit Ekonomik N.P.T.ARHING (Jeton Canhasi B.I.) i mungojnë këto dëshmi lidhur me përmbushjen e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional:

- i mungon 1 ekspert i licencuar dhe me certifikatë për ndikimin në mjedis (i cili sipas Ligjit në fuqi do të duhej të ishte i licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor);
- OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën për 1 inxhinier i gjeodezisë, për arsye se z.Rexhë Sopa NUK ËSHTË INXHINIER I GJEODEZISË ashtu siç është kërkuar në DT, por është Bachelor i Gjeodezisë;
- 1 arkitekti të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Rrezarta Alidema Kukaj) i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 10 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës)
- 1 inxhinieri të ndërtimtarisë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Jeton Canhasi) i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 10 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës);
- 1 inxhinieri të elektroteknikës të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Besim Gojani) i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 10 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës);
- 1 inxhinieri të makinerisë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Qani Nuhiu) i mungon DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR;
- 1 inxhinieri të makinerisë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Bujar Komoni) i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 10

VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës);

- 1 inxhinieri të ujësjellësit dhe të kanalizimit të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Shaqir Cana) i mungon DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR; i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 10 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës);
- 1 inxhinieri të ujësjellësit dhe të kanalizimit të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Adnan Bekteshi) i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 10 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës);
- 1 inxhinieri të energjisë së efiçiencës të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Cenë Krasniqi) i mungon DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR; i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 5 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 5 vjeçare të punës);
- 1 eksperti të licencuar me certifikatë për mbrojtje kundër zjarrit të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Shaban Halili) i mungon DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES 10 VJEÇARE NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 5 vjeçare të punës);
- 1 eksperti të sigurisë dhe të kualitetit në punë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Liridon Mavraj) i mungon mungon DIPLOMA OSE CERTIFIKATA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR; DESHMIA PER PËRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën e punës);

Në baze të këtyre qe u ceken me lartë ne konstatojmë se O.E - **N.P.T.ARHING (Jeton Canhasi B.I.)** i rekomanduar për kontratë është plotësisht i papërgjegjshëm pasi qe nuk i plotëson asnjerën nga kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

AK **NP"TERMOKOS"Sh.a** më këtë rast ka vepruar në kundërshtim të plote me këto nene të LPP-së

Neni 1: Qëllimi i LPP

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, proceduarat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndërmarrjet, autorietet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 7: Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti Kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veproj në mënyrë transparente

Kundërshtimi: AK- ka vepruar në kundërshtim të plote më këtë nen, duke e propozuar të sukëseseshem një operator ekonomik i cili konsiderojmë se nuk është i përgjegjëshem duke mos i përbushur kërkesat e DT - **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional.**

Gjithashtu AK-ja nuk ka respektuar **Nenin 69,** si dhe dispozitat e **Nenit 59 të LPP-së** i cili parasheh qartë se: "*Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara ne Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit*".

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e **Nenit 41.3 të RRUOPP-së** pasi që ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i përmbush të gjitha kërkesat e kërkuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë, ndërsa neni i lartpërmendur e parasheh qartë se: Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së janë:

- Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.
- Tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).
- Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.
- Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE **N.N.SH "VIZION PROJECT"** si e bazuar
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 2,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftim për Vendimin e AK-së"
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
e) Nje kopje të "Kërkesës për Rishqyrtim"

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*